

Ne ndërtojmë së bashku një të ardhme
neutrale ndaj karbonit

Politika e Grupit Titan për Ndryshimet Klimatike

Qershor 2025
v1.1

Përmbajtja

Qëllimi	3
Fushëveprimi dhe Zbatimi	3
Vlerësimi i Rreziqeve dhe Mundësive nga Ndryshimet Klimatike	3
Strategjia për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike dhe Përshtatjen ndaj	
Ndryshimeve Klimatike	3
Zbutja e Ndryshimeve Klimatike	3
Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike	5
Qeverisja dhe Përgjegjësitë për Ndryshimet Klimatike	6
Angazhimi dhe Transparenca me Palët e Interesit	6
Administrimi i Politikës	6

Qëllimi

Grupi TITAN është në ballë të përpjekjeve të industrisë së çimentos për të luftuar ndryshimet klimatike. Ne jemi të përkushtuar për të arritur objektivat e përcaktuara në Marrëveshjen e Parisit COP21 për të kufizuar rritjen mesatare globale të temperaturës në 1.5°C mbi nivelet para-industriale, dhe për të përmbushur vizionin e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane për neutralitetin ndaj karbonit deri në vitin 2050. Qëllimi ynë është të arrijmë emetime neto zero të gazrave serrë në të gjithë zinxhirin tonë të vlerës deri në vitin 2050, duke ndjekur objektivat e bazuara në shkencë të përafërsuara me skenarin 1.5°C, si në periudhë afatshkurtër ashtu edhe në periudhë afatgjatë.

Politika e Grupit TITAN për Ndryshimet Klimatike (në tekstin e mëtejshëm "Politika") synon të:

- Përcaktojë qeverisjen dhe përgjegjësitë.
- Rris ndërgjegjësimin për punonjësit tanë, partnerët e biznesit dhe furnitorët.
- Sigurojë kornizën e kujdesit të duhur.
- Ndërtojë besimin me të gjitha palët e interesit duke komunikuar me transparencë dhe veprime bashkëpunuese.

Fushëveprimi dhe Zbatimi

Kjo Politikë zbatohet për të gjithë punonjësit e Grupit TITAN në të gjitha operacionet, degët dhe mbulon çdo aktivitet nën kontrollin tonë operativ. Derisa njësitë e biznesit brenda Grupit mund të zbatojnë politikën e tyre individuale mjedisore, të përshtatura me kërkesat e legjislacionit vendor, kështu politika duhet t'i përmbahen Politikës së Grupit, e cila duhet të jetë e integruar në sistemet e tyre të menaxhimit mjedisor.

Vlerësimi i Mundësive dhe Rreziqeve nga Ndryshimet Klimatike

Grupi TITAN po përfshin parimet e vlerësimit të materialitetit të dyfishtë, në një proces të integruar dhe të vazhdueshëm që përfshin hartëzimin dhe vlerësimin e ndikimit të operacioneve të Grupit në mjedis, si dhe vlerësimin e ndikimeve financiare të ndryshimeve klimatike në Grup.

Për të identifikuar dhe zbutur në mënyrë efektive ekspozime të tilla, Grupi menaxhon rreziqet e veta në përputhje me praktikën ndërkombëtare, duke përfshirë dimensionet kryesore të Menaxhimit të Rrezikut të Ndërmarrjes (ERM) në proceset, sistemet dhe qeverisjen e vet. Ndryshimi i klimës përfaqëson për Grupin TITAN një rrezik kryesor strategjik, i cili ndikon në të gjithë zinxhirin e vet të vlerës. Prandaj, ndryshimi i klimës vlerësohet dhe menaxhohet në mënyrë të centralizuar.

Ndikimet fizike dhe rreziqet e tranzicionit që rrjedhin nga ndryshimi i klimës, si dhe mundësitë nga kalimi në një ekonomi me karbon të ulët vlerësohen sipas rekomandimeve të Task Forcës për Shpalosjet Financiare të Lidhura me Klimën (TCFD) me anë të përdorimit të analizës së skenarëve të ndryshimeve klimatike bazuar në Panelin Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike (IPCC).

Strategjia për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike

Një strategji gjithëpërfshirëse për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike përfshin një qasje të dyfishtë: zvogëlimin e gazrave serrë (GHG) të emetuara nga prodhimi dhe zinxhiri ynë i vlerës në atmosferë ("zbutja") dhe/ose përshtatjen ndaj ndikimeve fizike të ndryshimeve klimatike ("përshtatja").

Zbutja e Ndryshimeve Klimatike

Ne po transformojmë proceset dhe gamën tonë të produkteve për t'iu përgjigjur sfidave mjedisore dhe për të ndihmuar në ndërtimin e qyteteve të sigurta dhe më të qëndrueshme. Duke kaluar në zgjidhje për ndërtim më të qëndrueshëm, me karbon të ulët dhe qarkor, ne i ndihmojmë klientët tanë të arrijnë praktika të qëndrueshme të ndërtimit dhe të përmbushin zotimet e tyre mjedisore.

Ne vendosim objektiva afatshkurtra të bazuara në shkencë (SBT) për periudhën (5-10 vjeçare) për të ulur emetimet brenda zinxhirit të vlerës së kompanisë në përputhje me kufizimin 1.5°C, por kemi edhe SBT afatgjatë për të ulur emetimet brenda zinxhirit të vlerës së kompanisë jo më vonë se viti 2050. Ne përcaktojmë indikatorë kryesorë të qartë të performancës (KPI)

duke mbështetur "qasjen 5C" në zinxhirin e vlerës klinker-çimento-beton-ndërtim-karbonizim, derisa hetojmë veprimet tona Përtej Zbutjes së Zinxhirit të Vlerës (BVCM) për të mbështetur përpjekjet globale.

1. Klinkeri

i. Lëndët e para alternative të dekarbonizuara

Meqenëse burimi më i madh i CO₂ në prodhimin e çimentos është kalcifikimi i lëndëve të para në furrë, përdorimi i burimeve alternative të materialeve të dekarbonizuara është një mundësi e rëndësishme për uljen e ndjeshme të emetimeve të CO₂ dhe promovimin e ekonomisë qarkore. Duke zëvendësuar gurin gëlqeror me materiale të dekarbonizuara, emetimet e procesit zvogëlohen. Grupi TITAN promovon përdorimin e lëndëve të para alternative të dekarbonizuara, mbetje nga industri të tjera, siç janë hiri i thatë, zgjyra, betoni dhe mbetjet nga demolimet.

ii. Bashkëpërpunimi

Rritja e përdorimit të lëndëve djegëse alternative në vend të lëndëve djegëse fosile jo të rinovueshme është një faktor i rëndësishëm drejt arritjes së objektivave të dekarbonizimit të Grupit TITAN. Përdorimi i lëndëve djegëse alternative në prodhimin e çimentos (bashkëpërpunimi) kontribuon në ruajtjen e burimeve natyrore, uljen e përgjithshme të emetimeve të gazrave serrë, devijimin e mbeturinave nga deponitë dhe konkurrueshmërinë afatgjatë të Grupit.

Grupi TITAN synon të sigurojë furnizimin duke investuar edhe në Partneritetet Publiko-Private (PPP), në përputhje të plotë me ambiciet e veta të qëndrueshmërisë dhe angazhimin për të marrë pjesë aktive në ekonominë qarkore. Grupi Titan mbështet më tej planet kombëtare për të ofruar një zgjidhje për problematikat e rëndësishme mjedisore të menaxhimit të mbeturinave.

iii. Llojet e reja të klinkerëve të çimentos dhe përdorimi i mineralizuesve

Ne po studiojmë klinkerë të rinj edhe pse ka kufizime në aplikim dhe pranim në treg. Ne e zgjerojmë procesin deri në nivel industrial, p.sh. CSA (Sulfoaluminati i Kalciumit) dhe përdorim mineralizues për të ulur konsumin e energjisë aty ku është e mundur.

iv. Efikasiteti termik dhe energjia e rinovueshme

Përdorimi efikas i energjisë termike është i nevojshëm në të gjitha aktivitetet e mbështetura nga sistemet e menaxhimit të efikasitetit të energjisë dhe/ose auditimet e energjisë. Për ta arritur këtë, Grupi TITAN:

- Monitoron me kujdes konsumin dhe efikasitetin e energjisë.
- Investon në pajisje dhe sisteme të menaxhimit efikas të energjisë.
- Eksploron mundësitë përmes zbatimit të teknologjive më të mira në dispozicion.
- Investon në dixhitalizimin e procesit, siç është optimizimi në kohë reale.
- Eksploron opsione të qëndrueshme, siç është hidrogjeni i gjelbër për të përmirësuar djegien.
- Përqendrohet në lëndë djegëse alternative me përmbajtje të lartë të biomasës.

v. Kapja, përdorimi dhe ruajtja e karbonit (CCUS)

CCUS mund të ndihmojë në uljen e emetimit të karbonit, në përmbushjen e objektivave të qëndrueshmërisë dhe kështu të kontribuojë në përpjekjet tona për të luftuar ndryshimet klimatike. Në përputhje me politikën e BE-së për klimën, së bashku me partnerët tanë të teknologjisë, Grupi TITAN është një nismëtar në kapjen, ruajtjen dhe përdorimin e karbonit, duke investuar në projekte që do të kapin emetimet e CO₂ dhe do t'i ruajnë ato përgjithmonë në vende gjeologjike për magazinim ose do t'i përdorin ato në prodhimin e betonit ose për prodhimin e produkteve të reja.

2. Çimento

i. Çimento dhe produkte të çimentos me sasi të vogël klinkeri

Grupi Titan po përshpejton hyrjen në treg të produkteve të reja ekologjike dhe zgjidhjeve me bazë të çimentos, duke u përpjekur për të pasur një rol udhëheqës në materialet inovative përmes investimeve në çimento dhe produkte të çimentos, të cilat mbështesin ndërtimin e qëndrueshëm.

- Një pjesë e konsiderueshme e portofolit tonë të produkteve të çimentos përfshin produkte të prodhuara me një përmbajtje klinkeri dukshëm më të ulët se ajo e OPC (Çimento Portland e Zakonshme), duke përdorur materiale të tilla si hiri i thatë, zgjyra, guri gëlqeror, pozolani, argjila e kalcinuar dhe Materiale të tjera Plotësuese Çimentore (SCM).
- Nëpërmjet degës së saj Separation Technologies LLC (ST), Grupi TITAN ofron hi të thatë me vlerë për përdorim në beton, i cili është një produkt me emetime jashtëzakonisht të ulëta të karbonit, duke mundësuar ulje të shtuar të emetimeve në zinxhirin e vlerës.
- Grupi TITAN po fiton qasje të drejtpërdrejtë në lëndët e para kryesore të dekarbonizuara, si natyrale ashtu edhe alternative, të cilat do të mundësojnë zgjerimin e ofertës së Grupit për produkte të çimentos me karbon të ulët.

ii. Efikasiteti elektrik dhe energjia e rinovueshme

Përdorimi efikas i energjisë elektrike është i nevojshëm në të gjitha aktivitetet e mbështetura nga sistemet e menaxhimit të efikasitetit të energjisë dhe/ose auditimet e energjisë. Për ta arritur këtë, Grupi TITAN:

- Monitoron me kujdes konsumin dhe efikasitetin e energjisë.
- Investon në pajisje dhe sisteme të menaxhimit efikas të energjisë.
- Eksploron mundësitë nga zbatimi i teknologjive më të mira të dispozicion.
- Investon në dixhitalizimin e proceseve, siç është optimizimi në kohë reale..

Për më tepër, Grupi TITAN është i përkushtuar për të zvogëluar varësinë e vet nga burimet e energjisë jo të rinovueshme për të përmbushur nevojat e tij totale të energjisë. Investimi në asete të rinovueshme, siç janë fotovoltaike për të gjeneruar energji elektrike dhe sigurimi i marrëveshjeve për blerjen e energjisë së gjelbër (PPA) është pjesë e strategjisë sonë.

3. Betoni

Dixhitalizim, dizajn i përmirësuar i përzierjes dhe përzierjet e reja

Duke përdorur mjete dixhitale dhe teknologji inovative, ne po ndjekim procesin e dekarbonizimit në të gjithë zinxhirin e vlerës së furnizimit/prodhimit dhe shpërndarjes duke:

- Dixhitalizuar procesin e prodhimit, siç është optimizimi në kohë reale.
- Optimizuar itinerarin dhe monitorimin në kohë reale të transportit të betonit.
- Prezantuar materiale inovative, duke përfshirë nanoteknologjinë dhe përzierjet e reja.

Ne shfrytëzojmë mundësinë për të ndarë njohuritë dhe ekspertizën tonë dhe për të promovuar betonin e gjelbër në ndërtim.

4. Ndërtimi

Uljet e konsiderueshme të emetimeve të CO₂ janë të arritshme duke zbatuar politika që adresojnë të gjithë ciklin jetësor të çimentos dhe betonit, duke ndryshuar mënyrën se si projektojmë dhe ndëtojmë struktura. Ne mund të përdorim më pak materiale për të ndërtuar dhe për t'i bërë ndërtesat më efikase në fushën e energjisë me vetitë e veçanta të betonit.

Grupi TITAN punon në të gjithë zinxhirin e vlerës së ndërtimit për të inkurajuar praktikën më të mira në arkitekturë dhe për të zvogëluar emetimin e karbonit në ndërtim përmes metodave të reja, të tilla si printimi 3D dhe komponentët modularë.

5. Karbonizimi

Karbonizimi i betonit i referohet reaksionit kimik midis dioksidit të karbonit nga atmosfera dhe hidroksidit të kalciumit të pranishëm në pastën e çimentos së betonit. Ky reaksion formon karbonat kalciumi dhe ujë, dhe liron nxehtësi. Procesi ndodh gjatë jetëgjatësisë së betonit dhe i shndërron strukturat e betonit në rezervuarë karboni, duke thithur dhe izoluar një pjesë të të liru të CO₂ gjatë prodhimit të çimentos.

Emetimet në Zinxhirin e Furnizimit dhe Zbutja Përtej Zinxhirit të Vlerës (BVCM)

Emetimet indirekte të gazrave serrë që ndodhin në të gjithë zinxhirin e vlerës së kompanisë, përtej kontrollit tonë të drejtpërdrejtë operativ (të referuara si emetime të nivelit 3) përfshijnë burime të ndryshme, duke përfshirë nxjerrjen dhe prodhimin e materialeve të blera, transportin, përdorimin e produkteve të shitura dhe trajtimin e përfundimit të jetëgjatësisë së produkteve. Për ta adresuar këtë, Grupi TITAN angazhohet me furnitorët për të identifikuar mundësitë për uljen e emetimeve.

Për më tepër, Grupi TITAN po përqafon rekomandimet e bëra nga SBTi mbi nevojën për veprime dhe investime jashtë kufijve të zinxhirit tonë të vlerës dhe do të bashkëpunojë me palët e interesit për të hartuar dhe zbatuar strategji që do të ndihmojnë në përsheptimin e uljes së emetimeve të gazrave serrë duke punuar drejt një zeroje neto në nivel global. Grupi Titan konfirmon se BVCM nuk do të zëvendësojë ose vonojë përpjekjet për të ulur emetimet e saj në nivelin 1, 2 dhe 3 në përputhje me kufizimin 1.5°C.

Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike

Rritja e mundshme e rreziqeve fizike që lidhen me ndryshimet klimatike, siç janë përmytjet bregdetare, thatësira, mungesa e ujit, zjarret në pyje, temperaturat ekstreme etj., mund të çrregullojnë bazën tonë të aseteve dhe të dëmtojnë vazhdimësinë e operacioneve tona (prodhimin dhe/ose shpërndarjen). Ky lloj i rreziqeve vlerësohet dhe zbutet përmes një procesi të vlerësimit të rrezikut, të kryer në nivel Grupi dhe lokal, me një nivel të lartë përgatitjeje, duke ndjekur standarde rigorozë të projektimit, plane emergjence dhe të mbulimit të sigurimit, dhe duke përfshirë të dhëna nga studimet e rrezikut klimatik bazuar në analizën e skenarëve.

Grupi TITAN investon sistematikisht në pajisje dhe sisteme për të parandaluar ose zbutur rreziqet fizike të ndryshimeve klimatike dhe ofron mbulim të mjaftueshëm të sigurimit për dëmet ose ndërprerjet e përkohshme në punë, si dhe disponueshmërinë e burimeve të mjaftueshme financiare për të absorbuar çdo ndikim të mundshëm.

Qeverisja dhe Përgjegjësitë për Ndryshimet Klimatike

Bordi i Drejtorëve të Grupit (BD) ka përgjegjësinë e përgjithshme për të përcaktuar drejtimet strategjike të qëndrueshmërisë së kompanisë dhe për të marrë vendime për politika, duke i vendosur ndryshimet klimatike në ballë të axhendës së vet të qëndrueshmërisë. BD shqyrton performancën në lidhje me klimën të paktën çdo vit, si pjesë e vlerësimit të rrezikut dhe për procesin e planifikimit strategjik. Përgjegjësia e monitorimit të zbatimit të strategjisë së Qëndrueshmërisë së Grupit i caktohet **Komitetit Ekzekutiv të Grupit**, i përbërë nga Drejtorët Ekzekutivë, Drejtorët Rajonalë dhe Menaxherë të tjerë të Lartë të Grupit.

Zyrtari Kryesor i Qëndrueshmërisë dhe Inovacionit ka një rol udhëheqës në përpjekjet e Grupit për të përshtatur produktet, proceset dhe modelin e biznesit të vet me aspiratat e neutralitetit ndaj karbonit, duke qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë së qëndrueshmërisë. **Departamenti i Grupit për Performancë në fushën ESG** është përgjegjës për konsolidimin dhe monitorimin e performancës së Grupit në lidhje me ndryshimet klimatike, ndërsa **Departamentet e Grupit për Dekarbonizim si dhe të Inxhinierisë dhe Teknologjisë** janë përgjegjëse për zhvillimin dhe përditësimin e rregullt të planit të dekarbonizimit, si dhe mbikëqyrjen e veprimeve të Grupit, duke siguruar përmbushjen e objektivave.

Të gjithë punonjësit e Grupit TITAN, si dhe ata të kompanive të lidhura të TITAN-it, duhet të jenë në dijeni për zotimet e kësaj politike dhe duhet të marrin pjesë aktive në zbatimin e atyre zotimeve.

Kontraktuesit dhe furnitorët e TITAN-it, si dhe partnerët e biznesit përgjatë zinxhirit të vlerës, pritet të jenë në dijeni dhe t'i respektojnë plotësisht parimet e kësaj politike. Angazhimi i tyre për zbutjen e ndryshimeve klimatike konsiderohet si një faktor kryesor dhe është pjesë e kriterëve të vlerësimit në përputhje me Politikën e Grupit për Prokurim.

Grupi TITAN po përdor çmimin e brendshëm të karbonit në planifikimin e vet strategjik afatgjatë. Kjo qasje i mundëson kompanisë të vlerësojë rreziqet dhe mundësitë që rrjedhin nga mjedisi rregullator për gazrat serrë dhe kalimin në sasinë zero neto. Çmimi hije i karbonit teston fizibilitetin e shpenzimeve kapitale dhe vendimeve për investim në Kërkim dhe Zhvillim dhe mbështet arsyetimet për të zhvendosur investimet në opsione me karbon të ulët.

Përgjegjësia për arritjen e rezultateve për objektivat ESG të Grupit është përmirësuar duke lidhur performancën e CO₂ me pagën ekzekutive. Për më tepër, objektivat e reduktimit të CO₂ janë të lidhura edhe me sistemin vjetor të vlerësimit të performancës dhe shpërblimit të menaxherëve të njësive të biznesit (paga/bonusi).

Angazhimi dhe Transparenca me Palët e Interesit

Grupi TITAN mbështet Ambicien Klimatike 2050 të Shoqatës Globale të Çimentos dhe Betonit (GCCA), e cila është përpjekje e përbashkët e industrisë së çimentos drejt neutralitetit ndaj karbonit. Duke marrë pjesë aktive në fushata globale, si "Ambiciet e Biznesit për 1.5°C" dhe "Gara drejt Zeros" dhe Përsheptuesi i Tranzicionit Industrial (ITA), Grupi TITAN përqafton përgjegjësinë e vet për të krijuar një planet me emetime zero të karbonit. Grupi TITAN bashkëpunon me aktorët kryesorë globalë në të gjithë sektorët për të riformësuar së bashku peizazhin industrial, për të nxitur inovacionin në lidhje me klimën dhe për të përshpejtuar progresin drejt arritjes së emetimeve neto zero.

Si një kompani publike, TITAN S.A. duhet të përmbushë detyrimet rigoroze të qeverisjes dhe raportimit të Kodit Belg të Qeverisjes Korporative, Direktivës së Raportimit të Qëndrueshmërisë Korporative (BE), Rregullores së Taksonomisë së BE-së posaçërisht për ndryshimet klimatike dhe standardet më moderne të raportimit. Deklaratat e performancës së Grupit në fushën ESG auditohen nga verifikues të pavarur.

Së bashku me të gjitha palët e interesit, ne jemi të përkushtuar për të gjetur mënyra më të mira për të ndërtuar dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës. Ne veprojmë çdo ditë me integritet, empati dhe llogaridhënie mjedisore për të formësuar një të ardhme më të ndritur për të gjithë. Në nivelin e komunitetit lokal, Grupi TITAN promovon dialog të hapur me palët e interesit duke zbatuar nisma për qëndrueshmëri në të gjitha vendet, në lidhje me teknikat për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe masat për përshtatje.

Administrimi i Politikës

Departamenti i Grupit për Performancë në fushën ESG, së bashku me Departamentin për Dekarbonizim dhe Departamentin e Inxhinierisë dhe Teknologjisë, janë përgjegjës për administrimin dhe përditësimin periodik të kësaj politike. Çdo rishikim që paraqitet kërkon miratimin nga Komiteti Ekzekutiv i Grupit.